



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prenheno/Prodato Received/Delivered	05-05	2022	2	viti god year
Organ /Bjësia Organ./Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMST/EX	2611/2022		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 347/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 347/2022 të datës 08.04.2022, të parashtruar nga ankues.

me adresë banimi

kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "mase disiplinore", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 347/2022, të datës 08.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në pozitën Sekretar në Shkollën Fan S. Noli në Komunën e Podujevës, më datë 08.04.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1966/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore, kundër vendimit të datës 21.03.2022, me numër protokolli Nr. 05-148, të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1966/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës e datës 01.09.2017;Vendimi i datës 21.03.2022, me numër Nr. 05-148, të Komisionit për

Shqyrtimin e Ankesave; Vërejte me shkrim e datës 03.03.2022; Ankesa drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me shqiptimin e masës disiplinore vërejte me shkrim të shqiptuar nga Drejtori i SHMLT, „ Fan S. Noli“,, i cili mbanë pozitën „ Sekretar i SHMLT,„ Fan S. Noli““. Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar se për pozitën „Sekretar i SHMLT,„ Fan S. Noli“, në Podujevë nuk është pozitë e shërbyesit civil ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të nenit 2, paragrafi 4, të Ligjit NR. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **4.Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.**

Bazuar nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: **Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.**

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 347/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

